



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.1031/2016

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegji të përbërë nga gjyqtarët Kujtim Pasuli – kryetar i kolegjit, Nenad Llaziq dhe Nora Bllaca – Dula , anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësve A.H.1, F.H., L.H., R.Z. dhe të miturat A.2 dhe E.H., të cilët i përfaqëson, përfaqësuesi ligjor i ati A.H.1 , të gjithë nga Komuna e Istogut , e që të gjithë i përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Nikqi” & Associates, me seli në Pejë, kundër të paditurës K.S. “C...” me seli në Prishtinë për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës të paditurës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.228/2013 të datës 10.12.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur me 13.01.2020 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.PRANOHET pjesërisht ankesa e paditurës KS “C...”, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.228/13 të datës 10.12.2015, **NDRYSHOHET** në pjesën I të dispozitivit dhe atë:

Për paditësin A.H.1, përkitazi me dëmin jo material që ka të bëjë lidhur me dhimbje fizike dhe gjykohet në shumë prej 1.500 €, si dhe për frikë dhe gjykohet në shumë prej 1.200 €, ndërsa pjesa tjetër mbi shumën e aprovuar refuzohet si e pabazuar.

Për paditësin F.H., përkitazi me dëmin jo material që ka të bëjë lidhur me dhimbje fizike dhe gjykohet në shumë prej 1.500 €, si dhe për frikë dhe gjykohet në shumë prej 1.200 €, ndërsa pjesa tjetër mbi shumën e aprovuar refuzohet si e pabazuar.

Për paditësen L.H., përkitazi me dëmin jo material që ka të bëjë lidhur me dhimbje fizike dhe gjykohet në shumë prej 1.500 €, si dhe për frikë dhe gjykohet në shumë prej 1.200 €, ndërsa pjesa tjetër mbi shumën e aprovuar refuzohet si e pabazuar.

Për paditësen R.Z., përkitazi me dëmin jo material që ka të bëjë lidhur me dhimbje fizike dhe gjykohet në shumë prej 1.500 €, si dhe për frikë dhe gjykohet në shumë prej 1.200 €, ndërsa pjesa tjetër mbi shumën e aprovuar refuzohet si e pabazuar.

Për paditësen e mitur A.2 H., përkitazi me dëmin jo material që ka të bëjë lidhur me dhimbje fizike dhe gjykohet në shumë prej 1.500 €, si dhe për frikë dhe gjykohet në shumë prej 1.200 €, ndërsa pjesa tjetër mbi shumën e aprovuar refuzohet si e pabazuar.

Për paditësen e mitur E.H., përkitazi me dëmin jo material që ka të bëjë lidhur me dhimbje fizike dhe gjykohet në shumë prej 1.500 €, si dhe për frikë dhe gjykohet në shumë prej 1.200 €, ndërsa pjesa tjetër mbi shumën e aprovuar refuzohet si e pabazuar.

Në pjesën tjetër ankesa e të paditurës i paraqitur kundër aktgjykimit në fjalë refuzohet si i pa bazuar.

II.NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.228/13 të dt.10.12.2015, sa i përket kamatës së aprovuar i cili aktgjykim në atë pjesë ndryshohet ashtu që i padituri detyrohet që shumat e gjykuara me të njëjtin aktgjykim paditësve t'ia paguajë në lartësinë prej 8% në vit nga data e nxjerrjes së aktgjykimit të shkallës së parë dhe atë prej dt. 10.12.2015, e deri në pagesën definitive.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e goditur nën I të dispozitivit është aprovuar pjesërisht kërkesëpadiat e paditësve A.H.1 , F.H. ,L.H. , R.Z. dhe të miturat A.2 dhe E.H. , dhe është detyruar e paditura që në emër të kompensimit të dëmit jo materiale të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të dt. 10.08.2013 paditësve t'ia paguajë shumën e gjithmbarshme prej 34.000€ dhe atë : për paditësin A.H.1 shumën prej 5.500 € dhe atë në emër të dëmit jo material për dhimbje fizike shumën prej 3.500 € dhe në emër të frikës së përjetuar shumën prej 2.000 €. Për paditësin F.H. shumën prej 5.500 € dhe atë në emër të dëmit jo material për dhimbje fizike shumën prej 3.500 € dhe në emër të frikës së përjetuar shumën prej 2.000 €. Për paditësin L.H. shumën prej 5.500 € dhe atë në emër të dëmit jo material për dhimbje fizike shumën prej 3.500 € dhe në emër të frikës së përjetuar shumën prej 2.000 €. Për paditësin R.Z. shumën prej 5.500 € dhe atë në emër të dëmit jo material për dhimbje fizike shumën prej 3.500 € dhe në emër të frikës së përjetuar shumën prej 2.000 €. Për paditësin e mitur A.2 H. shumën prej 5.500 € dhe atë në emër të dëmit jo material për dhimbje fizike shumën prej 3.500 € dhe në emër të frikës së përjetuar shumën prej 2.000 €, dhe për paditësin e mitur E.H. shumën e përgjithshme prej 6.500 € dhe atë në emër të dëmit jo material për dhimbje fizike shumën prej 3.500 €, në emër të frikës së përjetuar shumën prej 2.000 € si dhe në emër të shëmtimit të pësuar shumën prej 1.000 €, me kamatë në lartësi prej 12 % duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive. Nën II të dispozitivit është detyruara e paditura që paditësve tua paguajë shpenzimet kontestimore në shumë prej 4082 €, të gjitha këto në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë. Kërkesëpadiat e paditësve përtej shumës së gjykuar më lartë, e që ka të bëjë me dëmin jo material në lartësi prej 6.000 € refuzohet si e pabazuar dhe atë për të gjithë paditësit nga 500 €.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë e paditura për shkak të :

- Shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore,
- Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe
- Zbatim të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën ndërsa aktgjykimin e atakuar ta ndryshojë ashtu që kërkesëpadiat e paditësve ta refuzojë si të pabazuar ose ta prishë dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk është parashtruar.

Duke vlerësuar aktgjykimin e goditur në pajtim me nenin 194 të LPK, në kuadër të kufijve të pretendimeve ankimore dhe duke pasur kujdes sipas detyrës zyrtare për shkeljet thelbësore të dispozitave të LPK-së të parapara me nenin 182 par. 2 dhe për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, gjeti se:

Ankesa është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit kanë parashtruar padi për kompensimin e dëmit jo material dhe material të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit me datë

10.08.2013. Me parashtrësën e datës 24.11.2015, i autorizuari i paditësve Shoqëria e Avokatëve “ Nikqi & Associates” ka precizuar kërkesëpadinë ashtu që për paditësin A.H.1 në emër të dhimbjeve fizike ka kërkuar shumën prej 4.000 €, për frikë shumën prej 2.000 €. Për paditësin F.H. , në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 4.000 €, frikë shumën prej 2.000 €. Për paditësen L.H. , në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 4.000 €, frikë shumën prej 2.000 €. Për paditësen R.Z., në emër të dhimbjeve fizike shumën prej 4.000 €, për frikë shumën 2.000 €. Për paditësen e mitur A.2 H. ,për dhimbje fizike shumën 4.000 €, frikë shumën prej 2.000€, dhe për paditësen e mitur E.H. për dhimbje fizike shumën prej 4.000 €, për frikë shumën prej 2.000 €, dhe për shëmtim shumën prej 1.000 €, të gjitha këto prestime nga pika I dhe II të paguajë me kamatë 12%, duke filluar nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit dhe vlerësimit të provave ka marr aktgjykimin më afër të përshkruar si më lart, duke gjetur se deri te aksidenti ka ardhur deri sa automjeti i markës Peugeot të cilën e drejtonte M.S., deri sa ishte duke qarkulluar nga drejtimi i rrugës Mojstir – Shoshicë , me të arritur në një kthesë, e duke mos ia përshtatur shpejtësinë kushteve të rrugës, e humb kontrollin ndaj veturës dhe kalon në shiritin e kundërt, me ç’rast e godet veturën e markës Opel Vectra të cilën e drejtonte A.H.1, e në të cilën gjendeshin paditësit të cilët si pasojë e këtij aksidenti pësojnë lëndime trupore. Sa i përket lartësisë së shumave të gjykuara vendimin e vet ka mbështetur duke pas parasysh mendimin e ekspertëve mjeko ligjor dr. I.K. ortoped – traumatolog dhe dr. M.H. neuropsikiatër, e duke pas parasysh edhe natyrën e lëndimeve të pësuar, dhe moshën e tyre si dhe sipas vlerësimit të saj të lirë e konform nenit 323 të LPK-së, duke konsideruar se shumat e gjykuara sado pak do të ndikojnë në arritjen e baraspeshës emocionale. Vendimin në fjalë gjykata e shkallës së parë mbështet në dispozitat e neneve 136, 179, dhe 183 të LMD-së. Vendimin për kamatë e mbështet në dispozitën e nenit 26 të Ligjit për Sigurim të Detyrueshëm të Auto përgjegjësisë, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës kontestimore bazon në nenet 449, 452, dhe 453 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës duke vlerësuar ankesën e të paditurës, ka gjetur se gjykata e shkallës së parë, duke vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike , drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe aktgjykimi i goditur nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare e në kuptim të nenit 194 e lidhur me nenin 182 par. 2 pika b) ,g),j),k) dhe m) të LPK. Njëherit nuk ka shkelje të dispozitave thelbësore të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika n) në të cilat thirret ankesa. Kjo për faktin se dispozitivi i aktgjykimimit të goditur është i qartë dhe nuk është kontradiktor me vetveten dhe me arsyetimin e aktgjykimimit. Në të janë treguar arsytet për faktet vendimtare për marrjen e vendimit dhe këto fakte janë të qarta dhe nuk janë kontradiktore.

Thëniet ankimore në drejtim të asaj se paditësit A.H.1, F.H. , L.H., dhe e mitura A.2 H. nuk kanë pësuar lëndim në aksident sepse të lartcekurit nuk figurojnë në raportin e policisë si të lënduar janë të pabazuara, sepse nga dokumentacioni mjekësor që gjendet në shkresat e lëndës pa mëdyshje rezulton se ka ekzistuar lidhja shkakësore e lëndimit të paditësve të lartcekur me aksidentin e ndodhur. Kjo aq më tepër kur nga gjithë dokumentacioni mjekësor që gjendet në shkresat e lëndës rezulton se vizita mjekësore është bërë në ditën e ndodhjes së aksidentit me dt. 10.08.2013, dhe në përshkrim figuron se ardhja në emergjencë ka të bëjë me aksidentin në komunikacion.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, me që përcaktimi i kompensimit për dëmin jo material paraqet zbatim të së drejtës materiale, atëherë kjo gjykatë gjen se shumat e gjykuar në emër të dhimbjes fizike dhe frikë për paditësit A.H.1, F.H., L.H., R.Z. dhe të miturat A.2 dhe E.H., janë marr me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ngase nuk kanë qenë adekuate dhe në përputhje me natyrën e shpërblimit të dëmit jo material, duke marr parasysh rëndësinë e shkallës së mirës dhe qëllimit që

shërben ky kompensim-shpërblim siç është paraparë me nenin 200 par. 1 e 2 të LMD-së dhe praktikave gjyqësore, për faktin se paditësit të lartcekur kanë lëndime të lehta trupore e të përcaktuara nga ekspertët mjekësor.

Kjo gjykatë duke pranuar pjesërisht ankesën e paditurës e ndryshoj aktgjykimin e gjykatës të shkallës së parë, ashtu që gjykoj për paditësin A.H.1, përkitazi me dëmin jo material që ka të bëjë lidhur me dhimbje fizike dhe gjykoj shumën prej 1.500 €, si dhe për frikë duke gjykuar shumën prej 1.200 €. Për paditësin F.H., përkitazi me dëmin jo material që ka të bëjë lidhur me dhimbje fizike dhe gjykoj shumën prej 1.500 €, si dhe për frikë duke gjykuar shumën prej 1.200 €. Për paditësen L.H., përkitazi me dëmin jo material që ka të bëjë lidhur me dhimbje fizike dhe gjykoj në shumë prej 1.500 €, si dhe për frikë duke gjykuar shumën prej 1.200 €. Për paditësen R.Z., përkitazi me dëmin jo material që ka të bëjë lidhur me dhimbje fizike dhe gjykoj shumë prej 1.500 €, si dhe për frikë duke gjykuar shumën prej 1.200 €. Për paditësen e mitur A.2 H., përkitazi me dëmin jo material që ka të bëjë lidhur me dhimbje fizike dhe gjykoj shumën prej 1.500 €, si dhe për frikë duke gjykuar shumë prej 1.200 €. Për paditësen e mitur E.H., përkitazi me dëmin jo material që ka të bëjë lidhur me dhimbje fizike dhe gjykoj në shumë prej 1.500 €, si dhe për frikë duke gjykuar shumë prej 1.200 €, duke pasur parasysh moshën e paditësve në kohën kur kanë pësuar fatkeqësinë, natyrën e lëndimeve të pësuarra e që kanë karakter të lëndimeve të lehta trupore, si dhe qëllimin e shpërblimit të dëmit jo material dhe se tani kjo gjykatë konsideron se me ndihmën e shumave të caktuara-gjykuara, paditësit mund të përjetojnë një satisfaksion të konsiderueshëm për këtë lloji të dëmit.

Sa i përket pjesës refuzuese është vërtetuar drejtë se nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të LPK, dhe drejtë është vërtetuar gjendja faktike dhe gjykata e shkallës së parë në këtë drejtim ka dhënë arsye të mjaftuara e të cilat arsye në tërësi i pranon edhe kjo gjykatë, si dhe drejtë është aplikuar edhe e drejta materiale.

Gjykata e Apelit e Kosovës duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale ka gjetur se gjykata e shkallës së parë për kamatë ka vendosur duke zbatuar gabimisht të drejtën materiale, përkatësisht dispozitën e nenit 26 të Ligjit për Sigurim të Detyrueshëm të Auto përgjegjësisë, e kjo për faktin se në shkresat e lëndës nuk ka asnjë dëshmi se paditësit tek e paditura kanë paraqitur kërkesë për akordimin e akontacionit, prandaj në mungesë të kësaj kërkesë nuk ka mundur të aprovohet kamata në lartësi prej 12% , prandaj edhe u ndryshua duke e aprovuar kamatën në lartësi prej 8 %, në vit e në kuptim të nenit 382 të LMD-së, duke marr për bazë faktin se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur me dt. 10.08.2013.

Nga arsyet e cekura ankesa e të paditurës tregohet pjesërisht e bazuar, prandaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 195 par.1 pika e) të LPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1031/2016 me dt.13.01.2020

Kryetari i kolegjit – gjyqtari
Kujtim Pasuli

Ac.nr.1031/16

PROCESVERBAL MBI KËSHILLIMIN DHE VOTIMIN

I përpiluar pranë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.01.2020.

TË PRANISHËM JANË:

Kryetari i kolegjit-gjyqtari Kujtim Pasuli
Anëtarët e kolegjit-gjyqtarët Nenad Llaziq e Nora Bllaca- Dula .

duke vendosur sipas ankesës të paditurës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.228/2013 të datës 10.12.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur me 13.01.2020 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.PRANOHET pjesërisht ankesa e paditurës KS “C...”, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, C.nr.228/13 të datës 10.12.2015, **NDRYSHOHET** në pjesën I të dispozitivit dhe atë:

Për paditësin A.H.1, përkitazi me dëmin jo material që ka të bëjë lidhur me dhimbje fizike dhe gjykohet në shumë prej 1.500 €, si dhe për frikë dhe gjykohet në shumë prej 1.200 €, ndërsa pjesa tjetër mbi shumën e aprovuar refuzohet si e pabazuar.

Për paditësin F.H., përkitazi me dëmin jo material që ka të bëjë lidhur me dhimbje fizike dhe gjykohet në shumë prej 1.500 €, si dhe për frikë dhe gjykohet në shumë prej 1.200 €, ndërsa pjesa tjetër mbi shumën e aprovuar refuzohet si e pabazuar.

Për paditësen L.H., përkitazi me dëmin jo material që ka të bëjë lidhur me dhimbje fizike dhe gjykohet në shumë prej 1.500 €, si dhe për frikë dhe gjykohet në shumë prej 1.200 €, ndërsa pjesa tjetër mbi shumën e aprovuar refuzohet si e pabazuar.

Për paditësen R.Z., përkitazi me dëmin jo material që ka të bëjë lidhur me dhimbje fizike dhe gjykohet në shumë prej 1.500 €, si dhe për frikë dhe gjykohet në shumë prej 1.200 €, ndërsa pjesa tjetër mbi shumën e aprovuar refuzohet si e pabazuar.

Për paditësen e mitur A.2 H., përkitazi me dëmin jo material që ka të bëjë lidhur me dhimbje fizike dhe gjykohet në shumë prej 1.500 €, si dhe për frikë dhe gjykohet në shumë prej 1.200 €, ndërsa pjesa tjetër mbi shumën e aprovuar refuzohet si e pabazuar.

Për paditësen e mitur E.H., përkitazi me dëmin jo material që ka të bëjë lidhur me dhimbje fizike dhe gjykohet në shumë prej 1.500 €, si dhe për frikë dhe gjykohet në shumë prej 1.200 €, ndërsa pjesa tjetër mbi shumën e aprovuar refuzohet si e pabazuar.

Në pjesën tjetër ankesa e të paditurës i paraqitur kundër aktgjykimit në fjalë refuzohet si i pabazuar.

II.NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.228/13 të dt.10.12.2015, sa i përket kamatës së aprovuar i cili aktgjykim në atë pjesë ndryshohet ashtu që i padituri detyrohet që shumat e gjykuara me të njëjtin aktgjykim paditësve t’ia paguajë në lartësinë prej 8% në vit nga data e nxjerrjes së aktgjykimit të shkallës së parë dhe atë prej dt. 10.12.2015, e deri në pagesën definitive.

Anëtarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit

1. Nenad Llaziq

Kujtim Pasuli

2. Nora Bllaca - Dula